



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/
Ministry of Internal Affairs
Inspektorati Policor i Kosovës



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

RAPORTI VJETOR 2013



PËRMBAJTJA

2013

RAPORTI VJETOR

| | | |
|-------|--|----|
| I. | FJALA HYRËSE E MINISTRIT, | 6 |
| II. | FJALA HYRËSE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV, | 7 |
| III. | HYRJE, | 8 |
| IV. | SFIDAT DHE TË ARRITURAT KRYESORE TË IPK-së GJATË VITIT 2013, | 9 |
| V. | PRANIMI I ANKESAVE DHE HETIMI I RASTEVE GJATË VITIT 2013, | 11 |
| VI. | INSPEKTIMET GJATË VITIT 2013, | 24 |
| VII. | MBËSHTETJA ADMINISTRATIVE DHE LOGJISTIKE TË FUNKSIONEVE TË IPK-së GJATË VITIT 2013, | 31 |
| VIII. | BASHKËPUNIMI ME QYTETARËT, ORGANIZATAT VENDORE , | 35 |
| IX. | BASHKËPUNIMI I IPK-së ME ICITAP-in AMERIKAN, | 38 |
| X. | BASHKËPUNIMI I IPK-së ME EULEX-in DHE OSBE-në, | 40 |
| XI. | BASHKËPUNIMI NDERKOMBËTAR I IPK-së, | 41 |
| XII. | PËRFUNDIME, | 43 |

FUSHËVEPRIMI I IPK-së

FUSHËVEPRIMI I IPK-së

1. Objekt i veprimtarisë së IPK-së është:

1.1. parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit së detyrës ose jashtë saj;

1.2. inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi;

1.3 hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës.

1.4 hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv;

1.5 kur ekziston dyshimi i bazuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka kryer shkelje disiplinore, Kryeministri mund të autorizon IPK-në për zhvillim të hetimeve disiplinore. IPK-ja pas përfundimit të hetimeve disiplinore i raporton Kryeministrit për të gjeturat;

1.6 pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga IPK dhe cilat do t'i referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve përgjegjëse.

MISIONI i IPK-së

MISIONI I IPK-së

Misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.



FJALA HYRËSE E MINISTRIT

z. Bajram Rexhepi
Ministër i Punëve të Brendshme



FJALA HYRËSE E MINISTRIT

Ministria e Punëve të Brendshme përmes Inspektoratit Policor të Kosovës, si mekanizëm i pavarur që ka për qëllim mbikëqyrjen e mënyrës së kryerjes së detyrave policore nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës, edhe gjatë vitit 2013 ka kryer me sukses misionin e tij duke u përkujdesur që ligji është zbatuar në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase.

Ministria e Punëve të Brendshme gjatë vitit 2013 ka arritur të realizoj disa objektiva që ndërlidhen me fuqizimin e Inspektoratit Policor të Kosovës në aspektin funksional dhe organizativ. Në këtë drejtim është bërë rekrutimi dhe trajnimi i 15 inspektorëve shtesë duke rritur numrin e përgjithshëm të stafit të Inspektoratit në 72 si dhe janë përmirësuar kushtet dhe mjediset e punës për stafin e Inspektoratit duke u akomoduar në objektin e ri si projekt kapital i Ministrisë së Punës së Brendshme.

Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët e Republikës së Kosovës, është bërë rishikimi i udhëzimeve të brendshme administrative dhe këto ndryshime ligjore do të ndikojnë në rritjen e mëtejme të efikasitetit të Inspektoratit Policor si dhe përmbushjen e misionit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për fuqizimin e sundimit të ligjit dhe garantimin e sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës përmes aplikimit të një qasje moderne, profesionale, transparente dhe respektimit të drejtave të njeriut. Reformat e ndërmarra me vite që kanë për qëllim fuqizimin e Inspektoratit Policor të Kosovës janë duke dhënë rezultate të konsiderueshme në praktikë. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2013 Inspektorati ka trajtuar 1050 ankesa të pranuar nga qytetarët dhe kjo dëshmon për besimin që kanë fituar të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës në këtë Institucion. Si një mekanizëm mbikëqyrës dhe i pavarur, ky institucion ka mundësuar ruajtjen e besimit të qytetarëve tek Policia e Kosovës

si një organizatë profesionale që bazohet në parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të secilit individ. Për më tepër, të dhënat e vitit 2013, dëshmojnë që ky besim gradualisht është duke u shtuar edhe tek qytetarët e komuniteteve joshumicë të Republikës së Kosovës.

Puna e Inspektoratit Policor të Kosovës gjatë vitit 2013 ka pasur shtrirje të gjerë, duke trajtuar 1050 ankesa të qytetarëve nga të cilat 804 janë ankesa disiplinore të profilit të ultë, 5 janë ankesa disiplinore të profilit të lartë dhe 241 ankesa janë me elemente penale.

Viti 2014 do të jetë vit i konsolidimit institucional dhe zbatimit të mandatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme në tërë territorin e Kosovës.

Në këtë drejtim edhe roli dhe rëndësia e vazhdimit të punës profesionale dhe efikase e Inspektoratit Policor në arritjen e këtyre objektivave është kyçe. Inspektorati do të garantojë qytetarët se Policia e Kosovës ushtron përgjegjësitë e saj në përputhje me ligjin dhe standardet më të avancuara ndërkombëtare dhe mbi të gjitha, të garantojë se po respektohen të drejtat dhe liritë themelore të individit, të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe konventat ndërkombëtare. Së këndejmi ftoj të gjithë qytetarët e vendit të bashkëpunojnë me Inspektoratin Policor të Kosovës, duke shprehur njëkohësisht besimin se bashkërisht do të vazhdojmë me një angazhim të shtuar në drejtim të përmirësimit të performancës së Policisë së Kosovës, në bazë të standardeve dhe praktikave më të avancuara ndërkombëtare duke u ndjekur nga parimet e profesionalizmit, transparencës dhe mos diskriminimit.

Duke përgëzuar për punën dhe angazhimin e zyrtarëve dhe menaxhmentit të Inspektoratit Policor të Kosovës, shfrytëzoj rastin të konfirmoj përkrahjen time të plotë për fuqizimin dhe funksionimin e pavarur të këtij mekanizmi në vazhdimin e sukseseve që janë arritur deri më tani.

FJALA HYRËSE E KRYESHEFIT

z. Fitim Shishani
Kryeshef Ekzekutiv
Inspektorati Policor i Kosovës



FJALA HYRËSE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, jam i lumtur të paraqes për ju raportin vjetor të Inspektoratit Policor të Kosovës për vitin 2013.

Si një Agjenci e pavarur e zbatimit të Ligjit, e konsoliduar në tërësi, IPK-ja edhe në vitin që lamë pas ka treguar se është e Përgatitur, Profesionale dhe Objektive në realizimin e misionit ligjor që ka.

Duke gëzuar këto cilësi, ne kemi arritur që edhe në vitin 2013, jo vetëm ta ruajmë kredibilitetin si Institucion profesional, por edhe të kultivojmë një bashkëpunim dhe besim ende më të madh me qytetarët tanë.

Duke shfrytëzuar autorizimet ligjore, ne kemi luajtur rolin tonë, për të kontribuar që Policia e Republikës së Kosovës, të jetë një institucion në shërbim të respektimit dhe zbatimit të ligjit, në shërbim të demokracisë dhe në shërbim të shoqërisë sonë.

Reformat e vazhdueshme, hyrja në fuqi e strukturës së re organizative, vazhdimi i trajnimeve më të avancuara për stafin tonë, nga ICITAP-i Amerikan dhe partnerëve tjerë ndërkombëtar, sigurimi i kushteve më të mira për punonjësit dhe mirëqenia e tyre etj, janë disa nga segmentet që e karakterizojnë Inspektoratin Policor të Kosovës në vitin 2013. Për këto të arritura shfrytëzojmë rastin ta

falënderojmë MPB-në për ndihmën e pa kursyer drejt zhvillimit të IPK-së.

Për Inspektoratin Policor, viti 2013, do të mbahet mend edhe për një fakt tepër të rëndësishëm në punën e saj, ne sot kemi të përcaktuar në çdo rajon të Kosovës nga një Prokuror, i cili ekskluzivisht merret me rastet e IPK-së dhe koordinon veprimet e mëtejme në lidhje me hetimet. Një gjë e tillë i mundëson hetuesve të IPK-së që të jenë, të Përgatitur, Profesional dhe Objektive në punën e tyre. IPK i falënderohet z. Robert J. Higdon, Shefi i Divizionit Kriminal pranë Zyrës të Prokurorit të Përgjithshëm të shtetit të Karolinës Veriore, për kontributin e tij profesional në arritjen e këtij bashkëpunimi IPK-Prokurori.

Duke kujtuar të arriturat dhe sfidat që patëm në vitin që lamë pas, ne i falënderojmë të gjithë ata që kontribuuan në zhvillimin permanent të IPK-së, në rritjen e performancës si dhe përgjegjshmërisë tonë. Natyrisht për këtë një rol të veçantë ka ICITAP-i Amerikan, pastaj EULEX, OSBE etj. Duke qenë të Përgatitur për punën tonë, Profesionale e Objektive, Inspektorati Policor i Kosovës, siguron qytetarët e vendit, se ne do të punojmë, për tu kujdesur, që ti përmirësojmë shërbimet tona dhe qëllim kryesor do të kemi rritjen e besimit në sundimin e ligjit.

III. HYRJE

Ky është raporti përmbledhës i punës së Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) për periudhën Janar - Dhjetor 2013 i cili përmban aktivitete dhe të arritura të dokumentuara. IPK-ja ka punuar dhe menaxhuar sipas qëllimeve dhe objektivave të parapara në planin strategjik 2012-2015 duke arritur rezultate të qëndrueshme dhe domethënëse.

Ky raport prezanton sfidat dhe aktivitetet e ndërmarra bazuar në kompetencat e parapara me legjislacionin në fuqi, të arriturat kryesore gjatë kësaj periudhe, vështirësitë në përmbushjen e objektivave strategjike dhe sfidat që e presin në të ardhmen.

Inspektorati Policor i Kosovës aktivitetet i ka zhvilluar përmes departamenteve operative që ushtrjnë funksione hetuese dhe inspektuese që janë: Departamenti i Hetimeve, Departamenti i Inspektimeve, Departamenti i Testit të Integritetit dhe Departamenti për Analizimin e Informacionit dhe Menaxhimin e Ankesave, kurse Departamenti i Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse ushtron aktivitet mbështetës në funksion të departamenteve operative. Në vitin 2014 pritet implementimi i Strukturës së re të Inspektoratit e cila përshkruhet në vazhdim.

Në raport prezantohet misioni dhe forma e organizimit të IPK-së për të vazhduar me pjesët tjera të këtij raporti vjetor ku përmbledhen sfidat kryesore gjatë vitit në realizimin e funksioneve operative (hetuese dhe inspektuese) si dhe funksioneve mbështetëse administrative.

Pjesa e bashkëpunimit me qytetarët, organizatat vendore dhe ndërkombëtare përmban aktivitete konkrete të bashkëpunimit të IPK-së me qytetarët. Përmes kampanjave të ndryshme të informimit lidhur me të drejtat e tyre, formën dhe mekanizmat e ankimit kemi ngrit nivelin e vetëdijesimit të tyre sa i përket qasjes në IPK. Ngritja e Profesionalizmit dhe ndikimit pozitiv në performancë është arritur përmes bashkëpunimit me organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare përmes shkëmbimit të përvojave, trajnimeve, pranimit të këshillimeve dhe mekanizmave tjerë me interes për IPK-në.

Pjesa përfundimtare e këtij raporti përmbledh objektivat dhe aktivitetet e vitit 2014 që janë planifikuar të realizohen.

IV. SFIDAT DHE TË ARRITURAT KRYESORE TË IPK-së GJATË VITIT 2013

Plani Strategjik 2012-2015 është baza e drejtimit të IPK-së sa i përket arritjes të qëllimeve dhe objektivave të këtij plani. Këtu janë përfshirë një seri objektivash që për IPK-në janë manifestuar në një spektër sfidash duke përfshirë çështjen e kushteve të punës deri tek ngritja e komunikimit në mes departamenteve. Megjithëse jemi duke arritur sukses domethënës kemi ende punë për të bërë për ti realizuar me sukses këto objektiva.

Mandati ligjor i IPK-së si agjenci e pavarur, pos tjerash i shërben edhe Policisë së Kosovës që ajo të zbatojë suksesshëm mandatet e saja ligjore. Kjo dëshmohet përmes hetimeve të kryera sipas ligjit dhe inspektimeve të cilat i mundësojnë udhëheqësisë së PK-së në vendimmarrje më të mirë për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit.

Zbatimi i mandateve ligjore të IPK-së ndërlihet me kapacitetet njerëzore dhe financiare që ka kjo agjenci. Andaj, gjatë vitit të kaluar IPK-ja ka rekrutuar dhe trajnuar 15 hetues / inspektor të rinj duke rritur burimet hetimore dhe inspektuese.

Një ndër sfidat e vazhdueshme të IPK-së, e identifikuar edhe në Planin Zhvillimor Strategjik, ishte vendosja dhe ruajtja e standardeve profesionale në zbatimin e mandateve ligjore të IPK-së. Rregullimi i brendshëm dhe ngritja e kapaciteteve të IPK-së përmes trajnimit mundëson parandalimin dhe hetimin e korrupsionit dhe aktiviteteve tjera kriminale brenda Policisë së Kosovës po ashtu edhe keqmenaxhimin e personelit ose financave.

Këtë sfidë IPK-ja e ka përballuar duke hartuar dhe rishikuar udhëzimet administrative dhe rregulloret që rezultojnë me një ristrukturim të analizuar mirë i cili pritet që të ngris kapacitetet dhe llogaridhënien menaxheriale, qartësinë funksionale të departamenteve, funksionalizimi i nivelit të divizioneve që deri më tani nuk ishin në funksion dhe qartësi sa i përket mundësisë së ndërtimit të karrierës afatgjate në agjencinë tonë.

Edhe pse për një kohë të gjatë çështja e akomodimit dhe krijimit të kushteve të mira për punë kishte qenë një sfidë e përhershme, nga viti i kaluar kjo sfidë nuk ekziston më dhe IPK-ja tanimë ka kushte ideale për punë të cilat do të ndikojnë në ngritjen e kualitetit të punës.

IPK do të vazhdoj të sigurojë shërbim më të mirë për Policinë e Kosovës, qytetarët, për akterët-partnerët e saj të jashtëm dhe të brendshëm përmes një shërbimi i cili do të jetë i kompletuar, korrekt, i kujdesshëm, i kryer me përkushtim, me mirësjellje, dhe i qartë.

IPK edhe këtë vit do të mbajë afër dhe do të shfrytëzojë përparimet e fundit të teknologjisë informative për t'i shërbyer më mirë Policisë së Kosovës në ngritjen e profesionalizmit të saj dhe qytetarëve të saj. Rifreskimi dhe zgjerimi i sistemit operativ të TI-së lidhur me zbatimin e mandateve ligjore, pajisjeve dhe softuerit, do të bëjë ridizajnimin e sistemit kompjuterik për përdorim nga departamentet lidhur me zgjidhjen e ankesave, hetimeve dhe disiplinës.


IPK do të përmirësoj akoma qendrën e ueb-portalit të IPK-së i cili ka linkun për ankesa të qytetarëve, formën e raportimit ad-hoc, dhe mundësitë për të përmirësuar imazhin dhe nxitjen e përdorimit të mjeteve të mediave sociale (Facebook, Twitter, dhe YouTube).

IPK ka arritur që edhe këtë vit të fuqizoj besimin e saj tek Policia e Kosovës, te qytetarët e Kosovës pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike apo religjioze.

IPK ka arritur që me sukses të trajtojë të gjitha ankesat e pranuar dhe me një efikasitet të lartë ti përcjellë në Policinë e Kosovës apo Prokurori për trajtim të mëtutjeshëm. IPK ka trajtuar me kujdes të gjitha indikacionet negative të menaxhimit policor duke iniciuar inspektime konkrete dhe duke dhënë rekomandime të qarta për menaxhmentin e lartë dhe ekzekutiv për përmirësimet e nevojshme.

Ndër sfidat e rëndësishme gjatë vitit 2013 ishte edhe vizibiliteti i organizatës tonë për tu gjendur gjithmonë afër menaxhmentit të Policisë së Kosovës, qytetarëve që kanë nevojë për shërbimet tona dhe akterëve tjerë me interes. IPK-ja vazhdimisht e ka njoftuar Policinë e Kosovës lidhur me aktivitetet hetimore dhe për të gjeturat nga inspektimet e ndërmarra si dhe vazhdimisht ka informuar qytetarët dhe grupet e interesit, duke treguar transparencë dhe gatishmëri për të punuar edhe me të tjerët të cilët ndajnë të njëjtin vizion për të pasur një polici të denjë dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve të saj.

Struktura Organizative e IPK-së - 2013



V. PRANIMI I ANKESAVE DHE HETIMI I RASTEVE GJATË VITIT 2013

Bazuar në kompetencat e dala nga ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, IPK-ja është e obliguar që të pranoj të gjitha ankesat e qytetarëve ndaj punonjësve të PK-së si dhe të shqyrtoj dhe përcaktoj se cilat nga ankesat hetohen nga IPK-ja dhe cilat do ti referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve tjera përgjegjëse.

Gjatë periudhës së raportimit Policia e Kosovës ka pasur 8458 punonjës. Në total 328 punonjës kanë qenë subjekt i hetimit të inspektoratit. Te paraqitur në formë përqindje kjo i bie që 4% i tërë punonjësve të PK-së ishin nën hetim. Në vitin 2013 janë 33 punonjës të PK-së më pak të hetuar se sa në vitin 2012.



Diagrami 1.



Çdo hetim që e ndërmerr IPK-ja inicohet ose përmes ankesës ose sipas detyrës zyrtare të IPK-së.

Për periudhën janar-dhjetor 2013, përmes 1064 ankuesve IPK-ja ka pranuar gjithsej 1050 ankesa lidhur me supozimet për shkelje disiplinore/penale të zyrtarëve policorë.

Këto ankesa kanë ardhur nga qytetarët tanë nga të gjitha komunitetet etnike dhe gjinore në forma të ndryshme ashtu siç parashihet me mekanizmat e ankimit të mbështetura me akte ligjore dhe nënligjore.

1064 ankues konsolidohen në 1050 ankesa të cilat IPK-ja i ka trajtuar. Ankesa mund të përfshijë më shumë se një ankues varësisht nga rrethanat.


Sipas statistikave të IPK-së, ankuesit janë nga këto etnitete:

- 1012 shqiptarë apo 95% e ankuesve;
- 38 serbë apo 4 % e ankuesve;
- 11 boshnjak apo 1% e ankuesve dhe 1 turk, 1 RAE dhe 1 goran.


Këto përqindje reflektojnë me përbërjen etnike të Republikës së Kosovës.

Sipas gjinisë, 983 ankues janë meshkuj apo 92% ndërsa 81 ankues femra apo 8%.

Diagrami 2.




Diagrami 3.



Sipas statistikave 1050 ankesat dhe iniciimet që janë pranuar nga IPK-ja në 2013 përbëjnë;

- 525 ankesa apo 50 % e ankesave janë inicim sipas detyrës zyrtare nga IPK-ja apo nga qytetarët përmes IPK-së;
- 352 ankesa apo 34% e ankesave janë inicim nga qytetarët përmes Policisë së Kosovës në IPK;
- 111 ankesa apo 11% e ankesave janë inicim i brendshëm nga vetë Policia e Kosovës;
- 45 ankesa apo 4% e ankesave inicim përmes Ueb-faqes zyrtare të IPK-së,;
- 16 ankesa apo 1% e ankesave janë inicim përmes organizatave tjera të ndryshme, dhe
- 1 ankesë është inicim anonim.

Diagrami 4.



SHEMBULL RASTI 1 :

Arrestohet një zyrtar policor për keqpërdorim të detyrës zyrtare

Hetuesit e Inspektoratit Policor të Kosovës – Departamenti i Hetimeve, kanë pranuar një informatë nga qytetarët për dyshimet për implikimin e një zyrtari policor të Stacionit Policor të Prizrenit në keqpërdorimin e detyrës zyrtare – marrje të ryshfetit.

Zyrtarët e IPK-së pas pranimit të informatës kanë kontaktuar me Prokurorin e Prokurorisë Themelore në Prizren ku me autorizimin e të njëjtit është iniciuar procedura hetimore.

Pas grumbullimit të informatave përmes rrugëve operative hetimore duke përfshirë edhe masat e fshehta të hetimit me autorizim të prokurorit përkatës, hetuesit e IPK-së nga Departamenti i Hetimeve kanë arrestuar zyrtarin policor (hetues) të Stacionit Policor të Prizrenit me dyshimin e bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, marrje të ryshfetit dhe ushtrim të ndikimit.

a) Analizimi, kategorizimi dhe shpërndarja e ankesave për hetime

804 ankesa apo 77% të ankesave të pranuar nga IPK-ja janë përcjellë pranë Drejtorisë për Hetime të Brendshme të Policisë së Kosovës pas analizimit dhe kategorizimit të tyre nga Departamenti për Analizën e Informacionit dhe Menaxhimin të Ankesave në IPK.

Në këto 804 ankesa janë përfshirë 1048 punonjës të PK-së.

Referimi te Drejtoria për Hetime të Brendshme të Policisë së Kosovës bëhet për shkak që ankesat nuk kanë pasur elemente të veprës penale apo nuk janë kualifikuar si shkelje disiplinore të profilit të lartë siç është e paraparë me Ligjin për IPK-në.

IPK-ja ka hetuar 246 raste të cilat janë kualifikuar si kompetencë e IPK-së për



hetim nga të cilat 241 raste kanë qenë raste me elemente të veprës penale apo 23% e ankesave të pranuar, ndërsa 5 nga këto ankesa kanë qenë raste disiplinore të profilit të lartë ku në total janë të përfshirë si të dyshuar 328 pjesëtarë të PK-së.

Tabela 1 .

| KATEGORIZIMI I 1050 ANKESAVE GJATË VITIT 2013 | | |
|--|---|--|
| Elemente për Hetime Disiplinore të profilit të ultë në kompetencë të Drejtorisë për Hetime të Brendshme të Policisë së Kosovës | Elemente të Veprës Penale në kompetencë të IPK-së | Elemente për Hetime Disiplinore të profilit të lartë në Kompetencë të IPK-së |
| 804 | 241 | 5 |
| 1050 | | |

Diagrami 5.




Sipas krahasimeve statistikore 2012-2013 lidhur me kategorizimin e ankesave për hetime në IPK për shkelje penale apo shkelje disiplinore të profilit të lartë të supozuar dhe për hetime në PK për shkelje disiplinore të profilit të ultë disiplinorë kemi këtë gjendje:

- për hetime në IPK për shkelje të supozuar penale apo shkelje të supozuar disiplinore të profilit të lartë gjatë vitit 2013 ishin 246 raste të hetuara nga IPK-ja ndërsa gjatë vitit 2012 ishin 302 raste të hetuara apo 56 raste më pak se vitin 2012, kurse,
- për hetime në PK për shkelje të supozuar disiplinore të profilit të ultë disiplinorë gjatë vitit 2013 ishin 804 raste të hetuara nga PK-ja ndërsa gjatë vitit 2012 ishin 776 raste të hetuara apo 28 raste më shumë se vitin 2012.

Në diagramin më poshtë do të gjeni në hollësi këto krahasime.

Diagrami 6.



b) Analizimi i trendit të ankesave sipas muajve


Gjate vitit 2013 kanë dominuar ankesat me elemente të shkeljeve disiplinore të cilat janë kompetencë e Policisë së Kosovës për hetime të brendshme¹.

Nga 246 ankesa te cilat janë kategorizuar si kompetencë e IPK-se për hetime penale ose shkelje disiplinore e profilit të lartë, sipas analizave të statistikave muajt më të ngarkuar me ankesa gjatë vitit 2013 kanë qenë muajt prill, qershor dhe shtator. Gjatë këtyre muajve numri i ankesave ka arritur shifrën 31-36 ankesa në muaj. Në krahasim me vitin 2012 muajt më të ngarkuar ishin muaji mars, maj dhe gusht ku numri i ankesave ka arritur shifrën 28-32 ankesa.

Mesatarja e ankesave të cilat janë në kompetencë të IPK-së për hetim gjatë vitit 2013 ishte 20 ankesa në muaj, ndërsa gjatë vitit 2012 kjo mesatare ishte 25 ankesa. Pra ky vit shënon një rënje prej 5 ankesave më pak për muaj në krahasim me vitin e kaluar.

¹ Për hollësira rreth statusit të këtyre ankesave mund të kontaktoni me zyrtarët përgjegjës pranë PK-së

Diagrami 7.



SHEMBULL RASTI 2 :

Arrestohet një zyrtar policor i dyshuar për vrasje

Më 2 nëntor 2013, rreth orës 16:00, Policia e Kosovës ka pranuar një informacion së në qytetin e Skenderajt, në rrugën “Skenderbeu”, në afërsi të xhamisë ka ndodhur një incident me të shtëna me armë zjarri dhe si pasojë e këtij incidentit një person ka mbetur i plagosur.

Bazuar në hetimet preliminare dyshohet se personi i dyshuar V. G. pjesëtar i Policisë së Kosovës, jashtë detyrës zyrtare, pas një mosmarrëveshje ka shtënë me armë zjarri në drejtim të viktimës B. B.

Personi i dyshuar në këtë rast – zyrtari policor, është arrestuar nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe me vendim të prokurorit të njëjtit i është caktuar masa e ndalimit për 48 orë dhe është suspenduar nga detyra.

IPK ka konfiskuar një armë GLOCK 9x19 që dyshohet se është përdorur nga i dyshuari në këtë rast dhe një karikator me 13 fishekë 9mm. Rasti është klasifikuar si vrasje bazuar në nenin 178 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

c) Statusi i rasteve të hetuara në IPK

Nga 1050 ankesa që ka pranuar IPK-ja në vitin 2013, me 241 raste të trajtuara me elemente penale 133 (55%) raste janë dërguar me kallëzim penal² nga Departamenti i Hetimeve në Prokuroritë kompetente. Ndërkaq me raport të veçantë³ janë dërguar 87 (36%) raste, kurse 21 (9%) raste janë në proces të hetimit⁴ të bartura për vitin 2014.

Inspektorati Policor i Kosovës ka arritur që 91% të rasteve me elemente kriminale ti hetoj dhe procedoj tutje në prokurori me kallëzim penal ose me raport të veçantë.

Këto të dhëna tregojnë për një ngritje të efikasitetit të IPK-së në 2013 për 13% në krahasim me vitin 2012 kur 78% të rasteve me elemente kriminale ishin proceduar tutje në prokurori me kallëzim penal ose me raport të veçantë kurse 22% e rasteve kishin mbetur në proces të hetimit të bartura për vitin 2013.

Tabela 2.

| STATUSI 241 RASTET ME ELEMENTE TE VEPRËS PENALE ne 2013 | | |
|---|----------------------|-------------------------|
| Rastet e dërguara në Prokurori | | Rastet në proces në IPK |
| 220 | | 21 |
| Me Kallëzim penal | Me Raport të veçantë | |
| 133 | 87 | |
| TOTALI | | 241 |

SHEMBULL RASTI 3:

Arrestohet zyrtari policor i përfshirë në aksidentin me pasoja fatale

Më 19.09.2013, rreth orës 16:30 ishte raportuar për një aksident trafiku në mes të një veture zyrtare të PK-së të llojit Toyota në të cilën ndodheshin tre punonjës të Policisë së Kosovës dhe një veture civile të llojit Volksäagen në të cilën ndodheshin katër meshkuj dhe një femër. Aksidenti ka ndodhur në një rrugë në fshatin Peran të Podujevës ku si pasojë e lëndimeve të rënda trupore nga ky aksident dy viktima meshkuj të cilët gjendeshin në veturën civile kanë ndërruar jetë kurse tre të tjerë kanë pësuar lëndime trupore si dhe tre punonjësit e PK-së nga vetura zyrtare.


Hetuesit e IPK-së, me autorizim të Prokurorit Publik kanë arrestuar zyrtarin policor S. F me dyshimin e bazuar se i niëti ka krver veprën penale "Rrezikim i trafikut publik".

²Siç është shpjeguar edhe në raportin e vitit të kaluar, IPK-ja përpilon kallëzim penal në të cilin paraqiten provat e zbuluara në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe i dorëzohet prokurorit të shtetit së bashku me sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet e masave dhe veprimeve të kryera, shënimet zyrtare, deklaratimet e marra dhe materialet e tjera të cilat mund të kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës.

³Nëse masat dhe veprimet e kryera nga Inspektorati Policor i Kosovës, provat dhe të dhënat e mbledhura nuk sigurojnë bazë për kallëzim penal dhe nëse kjo nuk justifikon ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer veprë penale, Inspektorati Policor i Kosovës dërgon për këtë raport të veçantë në prokurori.

⁴Rastet të cilat janë në proces konsiderohen rastet që vazhdojnë të hetohen nga Inspektorati Policor i Kosovës deri në ngritjen e kallëzimit penal pranë prokurorisë së shtetit ose dërgimin e tyre në DHB në mungesë të elementeve të veprës penale.

Diagrami 8.



d) Statusi i rasteve të IPK-së të proceduara në Prokurori me kallëzim penal

Nga 133 raste, prokuroria ka ngritur propozim akuzë apo aktakuzë ndaj të dyshuarve për 17 kallëzime penal dhe rastet janë proceduar për në gjykatat kompetente. 6 kallëzime penale janë hedhur poshtë në mungesë të fakteve. Si raste të mbyllura në prokurori janë 5 raste. 105 kallëzime penale të ngritura nga IPK-ja janë në proces në prokuroritë kompetente të Republikës së Kosovës.

Tabela 3

| STATUSI I 133 RASTEVE TË PROCEDUARA NË PROKURORI ME KALLZIM PENAL ne 2013 | |
|--|------------|
| Kallëzime penale me propozim akuzë apo aktakuzë të ngritur | 17 |
| Kallëzime penale të hedhura poshtë | 06 |
| Raste të mbyllura | 05 |
| Kallëzime penale në proces | 105 |
| Totali | 133 |

Për 17 kallëzime penale që është ngritur aktakuzë apo propozim akuzë nga prokuroria, gjykatat kompetente kanë marrë këto vendime:

- Tri aktgjykime me urdhër ndëshkimor;
- Gjashtë aktgjykime dënuese;
- Dy aktgjykime me dënim me gjobë;
- Një aktgjykim refuzues;
- Një aktgjykim lirues dhe
- Një marrëveshje për pranim të fajësisë.

e) Pesë rastet më të shpeshta të hetuara nga IPK-ja

Gjatë vitit 2013, IPK-ja ka hetuar raste të llojeve dhe natyrave të ndryshme. Prej 246 rasteve të hetuara të gjithsejtë 8458 punonjësve të PK-së nën hetim ishin 328 – apo 4% i totalit. Rastet më të shpeshta me elemente të veprës penale kanë qenë pothuajse të njëjta me rastet që ishin edhe gjatë vitit 2012. Pesë (5) rastet më të shpeshta që u hetuan gjatë vitit 2013 ishin:

- 43 raste rrezikim i trafikut publik,
- 38 raste lëndimi i lehtë trupor,
- 35 raste keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar,
- 30 raste keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare,
- 20 raste kanosje.

Për dallim nga viti 2012 kur rastet më të shpeshta në kompetencë të IPK-së për të hetuar ishin lëndim i lehtë trupor, keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës, shpërdorim i detyrës zyrtare apo autorizimit, rrezikim i trafikut publik, këtë vit prijnë rastet e rrezikim i trafikut publik, lëndimi i lehtë trupor, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe kanosje (shih më poshtë tabelën nr.4).

Tabela 4

| PESE (5) RASTET MË TË SHPESHTA TË HETUARA NGA IPK-ja KRAHASIM 2012-2013 | | | | |
|--|---|----|---|----|
| Nr. | Llojet e shkeljeve <u>2012</u> | | Llojet e shkeljeve <u>2013</u> | |
| Rastet me elemente të veprës penale | | | | |
| 1 | Lëndim i lehtë trupor | 52 | Rrezikim i trafikut publik | 43 |
| 2 | Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare | 45 | Lëndim i lehtë trupor | 38 |
| 3 | Shpërdorim i detyrës zyrtare apo autorizimit | 42 | Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar | 35 |
| 4 | Rrezikim i trafikut publik | 40 | Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare | 30 |
| 5 | Kanosje | 30 | Kanosje | 20 |

f) Veprat penale me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare të hetuara nga IPK-ja

Inspektorati Policor edhe gjatë këtij viti kujdes të veçantë i ka kushtuar edhe veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare. Këtë vit IPK-ja ka pranuar dhe hetuar 51 raste të veprave penale me elemente të korrupsionit dhe veprave tjera kundër detyrës zyrtare ndër të cilat më të shpeshtat kanë qenë: 35 raste të keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, 9 raste marrje ryshfeti, 2 raste të përvetësimit në detyrë, 2 raste të përdorimit të paautorizuar të pasurisë, 2 raste falsifikim i dokumentit zyrtar dhe 1 rast i zbulimit të fshehtësisë zyrtare.

Tabela 5.

| 51 RASTET ME ELEMENTE TE KORRUPSIONIT ZYRTAR DHE VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE GJATË VITIT 2013 | | | | | |
|--|--------------------|-------------------------------------|-----------------------|----------------------------------|-------------------------------|
| Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar | Marrja e ryshfetit | Përdorimi i paautorizuar i pasurisë | Përvetësimi në detyrë | Falsifikimi i dokumentit zyrtarë | Zbulimi i fshehtësisë zyrtare |
| 35 | 9 | 2 | 2 | 2 | 1 |
| 51 | | | | | |

SHEMBULL RASTI 4 : Operacioni "Ryshfeti"

Hetuesit e IPK-së kanë realizuar operacionin e koduar me emrin "Ryshfeti" me urdhëresën e Gjyqtarit të Procedurës paraprake duke kryer gjashtë bastisje në zonën e përgjegjësisë së Ferizajt. Gjatë operacionit janë arrestuar pesë të dyshuar nga të cilët dy janë zyrtarë policorë (një toger dhe një zyrtar policor). Hetimi për këtë rast është iniciuar muaj më parë nga hetuesit e Inspektoratit Policor të Kosovës dhe është udhëhequr nga prokurori i EULEX-it me dyshimin e bazuar se të dyshuarit kanë kryer veprat penale: keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, marrje e ryshfetit, ushtrim të ndikimit, dhënie të ndihmës kryerësve të veprës pas kryerjes së veprës penale dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm.

Realizimi i operacionit "Ryshfeti" është përkrahur edhe nga Njësi Special Operativ i Policisë së Kosovës, njësi i forensikës, Drejtoria kundër krimit të organizuar etj.

Hetuesit e IPK-së kanë bastisur gjashtë lokacione të ndryshme në Ferizaj duke përfshirë edhe një zyre në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Ferizaj. Si dëshmi materiale nga këto lokacione janë konfiskuar armë, municion, kompjuter, dokumente të ndryshme, para të gatshme etj.

g) Gradat e punonjësve të PK-së të hetuar nga IPK-ja

Policia e Kosovës gjatë vitit 2013 ka pasur një personel prej 8458 punonjësve. Siç dihet Policia e Kosovës ka një strukturë komplekse organizative me funksione dhe detyra të ndryshme dhe si e tillë është e ndarë në nënndarje të shumta me detyra dhe përgjegjësi të llojllojshme. Në kuadër të këtij raporti ne do të paraqesim shkeljet disiplinore të profilit të lartë dhe penale të Policisë së Kosovës të cilat janë në mandatin e IPK-së për tu hetuar sipas gradave në Policinë e Kosovës (shih tabelën nr. 6).

Tabela 6.


| GRADAT e PUNONJËSEVE TE PK-SË TË HETUAR NGA IPK ne 2013 | | | | | | | | | | | | | | |
|---|--|-------------------------|------------------------------------|---------|------------|-------|---------|-------|----------|----------------|-------|-----------------------|------------|---------------------|
| POLICIA E KOSOVËS | PERSONELI I PK SIPAS STRUKTURËS 30.12.2013 | | | | | | | | | | | TOTALI ZYRTAR POLICOR | STAF CIVIL | TOTALI I PERSONELIT |
| | DREJTORI PËRGJITH. I | ZV.DREJTORI PËRGJITH. I | DREJTORI DEPARTAMENTIT TË POLICISË | KOLONEL | NËNKOLONEL | MAJOR | KAPITEN | TOGER | RRESHTER | ZYRTAR POLICOR | KADET | | | |
| TOTALI I PËRGJITHSHEM | 1 | 2 | 5 | 13 | 38 | 30 | 135 | 302 | 682 | 6106 | 0 | 7314 | 1144 | 8458 |
| TE HETUAR nga IPK-ja | 0 | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 3 | 11 | 22 | 273 | 0 | 312 | 16 | 328 |

Siç shihet edhe nga tabela më lartë, PK-ja ka në total 8458 punonjës, nga të cilët 7314 janë të uniformuar dhe me grada të ndryshme, ndërsa personel civil - pa kompetenca policore janë 1144. Inspektorati Policor ka kompetencë që të hetoj të gjithë zyrtarët policor pa dallim grade dhe gjatë vitit 2013 ka hetuar raste nga shumica e gradave ekzistuese në Policinë e Kosovës.

Policia e Kosovës ka të graduar një personel prej 1208 oficerëve të cilët menaxhojnë të gjitha vijat e menaxhmentit, nga vija e parë menaxhuese e deri te niveli i lartë drejtues ekzekutiv. Në PK janë 682 rreshter, 302 toger, 135 kapiten, 30 majorë, 38 nënkolonelë dhe 13 kolonelë.

Gjatë vitit 2013 IPK-ja ka hetuar 39 zyrtar të graduar, prej tyre 1 kolonel , 2 nënkolonel, 3 kapiten, 11 toger, 22 rreshter, 273 zyrtarë policor si dhe 16 punonjësve nga stafi civil (shih diagramin nr. 8).


Diagrami 9.



h) Rajonet nga vinë punonjësit e PK-së të hetuar nga IPK-ja

Sipas statistikave të IPK-së nga DRP e Prishtinës subjekt i hetimeve të IPK-së ishin 69 punonjës , 53 në DRP e Pejës, 40 në DRP e Mitrovicës-Jugu, 6 në DRP e Mitrovicës- Veri, pastaj 34 nga DRP e Prizrenit, 36 nga Policia Kufitare e përcjellë me 14 nga DRP e Gjilanit dhe 30 nga DRP e Ferizajt ndërsa të gjitha njësitë tjera në Policinë e Kosovës kanë 82 punonjës të hetuar nga IPK-ja.

Diagrami 10.



e) Masat dhe rekomandimet e dhëna nga IPK-ja

Masat dhe rekomandimet e dhëna nga IPK-ja gjatë vitit 2013 të cilat kanë ardhur si kërkesa dhe nevoja gjatë zhvillimit të hetimeve janë:

- 16 arrestime nga ana e IPK-së,
- 46 rekomandime për suspendime nga Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe
- 2 rekomandime për transfer nga Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.

SHEMBULL RASTI 5:

Operacioni "Koordinimi"

Drejtoria për Hetimin e Krimit të organizuar në bashkëpunim me Inspektoratin Policor të Kosovës, Doganat e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës, ka bërë arrestimin e tetë personave të dyshuar nën dyshimin e bazuar se të njëjtit kanë kryer veprat penale 'krim i organizuar' dhe 'kontrabandim me mallra'

Operacioni i përbashkët sipas planit operativ i quajtur "Koordinimi" ka zgjatur me hetime për disa muaj me radhë dhe më 23 dhjetor 2013 ka rezultuar me arrestimin e tetë personave të dyshuar si dhe kontrollimin e 16 lokacioneve të ndryshme, ku prej tyre pesë shtëpi banimi dhe njëmbëdhjetë lokale afariste.

Hetimet lidhur me këtë rast janë zhvilluar me autorizim të prokurorisë speciale të Republikës së Kosovës, ku subjekt hetimi kanë qenë një grup i dyshuar kriminal nga Kosova dhe Maqedonia e që në vazhdimësi kanë kontrabanduar mallra nga Maqedonia në territorin e Kosovës duke shfrytëzuar rrugët ilegale.

Në disa raste ky grup i organizuar ka shfrytëzuar edhe pikë kalimin kufitar Hani i Elezit ku dyshohet që ka qenë i ndihmuar nga dy zyrtarë policor tashmë të arrestuar.

VI. INSPEKTIMET GJATË VITIT 2013

Një ndër funksionet bazë të Inspektoratit Policor të Kosovës është edhe zhvillimi i inspektimeve ndaj Policisë së Republikës së Kosovës, raportimi mbi punën dhe efikasitetin në arritjen e qëllimeve të menaxhmentit të saj dhe dhënia e rekomandimeve lidhur me efikasitetin, efektivitetin dhe pajtueshmërinë e punës policore me ligjet në fuqi, identifikimin dhe parandalimin e çfarëdo devijimi nga aktet ligjore dhe procedurat me të cilat funksionon Policia e Kosovës.

Përmes procesit të inspektimit, IPK-ja bënë vlerësimin e mënyrës së kryerjes së detyrave në Policinë e Kosovës, duke:



- Përcaktuar nëse ligjet, rregulloret përkatëse dhe parimet e procedurat e Policisë së Kosovës zbatohen ashtu si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e saj;
- Përcaktuar nëse burimet e Policisë shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj organizative;
- Parandaluar shkeljet që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së Policisë së Kosovës;
- Identifikuar mangësitë dhe duke rekomanduar masa ligjore e organizative për funksionimin më të mirë të Policisë së Kosovës.



Në drejtim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga legjislacioni për të ushtruar mbikëqyrje të përhershme mbi punën e organizatës policore, Departamenti i Inspektimeve ka bërë përgatitjet për realizimin e një numri inspektimesh në Policinë e Kosovës duke përpiluar Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta 2013 ku janë paraparë 4 inspektime të rregullta.

Identifikimi i fushave policore ku u zhvilluan këto Inspektime është e bazuar në rëndësinë e programeve/fushave policore, ndjeshmërinë e kompleksitetin e saj, riskun e identifikuar, frekuencën e inspektimit dhe nevojën e organizimit në kohën kur institucionet relevante kanë shtuar

përpjekjet për ngritjen e efikasitetit, efektivitetit dhe përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave.

Inspektorati Policor gjatë këtij viti ka realizuar katër inspektime të rregullta dhe dy të jashtëzakonshme ku janë inspektuar 81 njësi policore dhe janë inspektuar 142 dosje të ndryshme dhe janë intervistuar rreth 152 zyrtarë policorë të të gjitha gradave dhe pozitave. Fushat në të cilat ishin kryer inspektime ishin: fusha e njësive të specializuara, fusha e rendit publik, fusha e respektimit të drejtave të personave të ndaluar, fusha e prokurimit dhe fusha e menaxhimit me pajisje dhe pasuri të PK-së.

Në vazhdim do të paraqesim numrin, fushën e inspektuar dhe llojin e inspektimit për secilin inspektim. Nga gjashtë inspektime shkurtimisht do të prezantojmë edhe përmbajtjen nga pesë inspektimet e publikuara në ueb-faqen zyrtare të IPK-së ndërsa një raport i inspektimeve do të publikohet gjatë tremujorit të parë të 2014-së për shkak të procedurave që duhet ndjekur.

1. Inspektimet e rregullta të realizuara gjatë 2013-së janë:

- 1) Inspektimi i performancës së Njësive Speciale Operative (NJSO)
- 2) Vlerësimi i kushteve materiale dhe aspektit të sigurisë në Qendrat e Mbajtjes në Policinë e Kosovës
- 3) Inspektimi i Dhomës së Dëshmive në Policinë e Kosovës
- 4) Inspektimi i Prokurimit në Policinë e Kosovës

2. Inspektimet e jashtëzakonshme ishin:

- 1) Vlerësimi i performancës policore gjatë ndërrimit të natës më 24 maj 2013, mes të premtës dhe të shtunës, në Stacionet Policore dhe NJTR.
- 2) Vlerësimi i performancës, gatishmërisë, trajnimeve dhe kushteve të punës në NJSI



1) Vlerësimi i performancës policore gjatë ndërrimit të natës me 24 maj 2013, mes të premtës dhe të shtunës, në Stacionet Policore dhe NJTR.

Në maj të 2013-ës, në mes të premtës dhe të shtunës, Inspektorati Policor i Kosovës ka zhvilluar inspektim të jashtëzakonshëm lidhur me vlerësimin e performancës policore gjatë ndërrimit të natës nga njësitë e Divizionit të Sigurisë Publike gjegjësisht nga Komandat Regjionale, Stacionet Policore dhe Njësitë e Trafikut Regjional (NJTR).

Qëllimi i këtij inspektimi të jashtëzakonshëm ka qenë që të vlerësohet dhe të konstatohet kryerja e detyrave policore gjatë ndërrimit të natës lidhur me performancën e Policisë së Kosovës në ofrimin e sigurisë për qytetarët e vendit dhe në mbrojtjen e rendit dhe qetësisë publike.



Inspektorati Policor i Kosovës ka inspektuar gjithsej 34 stacione/njësi policore përfshi edhe gjashtë Drejtori Rajonale. Kriteret e përdorura gjatë këtyre inspektimeve kanë qenë elementare, si: numri i policëve në ndërrim, numri i të graduarve, elementet bazë të sigurisë së njësisve policore, elementet bazë të organizimit operativ dhe elementet bazë të organizimit administrativ.

Rekomandimet Kryesore:

1. *Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Policisë së Kosovës që menjëherë të inicioj inspektime dhe auditime të performancës së Drejtorive Rajonale lidhur me kapacitetet njerëzore të angazhuara gjatë ndërrimit të natës dhe të ndërmarr masa disiplinore ndaj Udhëheqësve të njësisve përbërëse të tyre të cilët neglizhojnë parimet dhe procedurat e Policisë së Kosovës.*

2. *Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Policisë së Kosovës që menjëherë të inicioj inspektime dhe auditime të performancës së Drejtorive Rajonale lidhur me kapacitetet Udhëheqëse- Gradave të angazhuara gjatë ndërrimeve të natës dhe të ndërmarr masa disiplinore ndaj Udhëheqësve të të gjitha niveleve të cilët neglizhojnë parimet dhe procedurat e Policisë së Kosovës.*

3. *Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Policisë së Kosovës që menjëherë të inicioj inspektime dhe auditime të performancës së Drejtorive Rajonale lidhur me elementet bazë të sigurisë së objekteve policore, patrullimit si planet e patrullave dhe oraret e tyre, komunikimin dhe mjetet për sigurimin e të drejtave të njeriut si libri i ankesave dhe gjendja e dhomës së ndalimit në baza rutinore dhe në ndërrime të ndryshme me qëllim të përmirësimit të gjendjes duke marrë masa disiplinore pa kompromis ndaj secilit që dështon në këto kritere bazë të policimit.*

2) Inspektimi i performancës së Njësive Speciale Operative (NJSO)

Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës dhe Planin Vjetor të Inspektiveve 2013, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektiveve ka bërë një inspektim të rregullt në Njësitë Speciale Operative (NJSO) të Policisë së Kosovës (PK).



Qëllimi i këtij inspektimi ishte që të vlerësohet niveli i performancës së Njësive të Specializuara Operative lidhur me përgatitjen e tyre profesionale, mbi detyrat dhe përgjegjësitë menaxheriale për udhëheqjen e këtyre njësive të specializuara si dhe rezultatet e punës së tyre.

Rekomandimet kryesore:

1. Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, që Divizioni i Njësive Speciale duhet të rishikoj PSO-në në fuqi që rregullon punën e NJSO-ve dhe ta harmonizoj me aktet ligjore në fuqi dhe ndryshimet organizative-strukturore që janë aprovuar për NJSO-të më 20.05.2012.
2. Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, që procesi i stabilizimit të strukturës së menaxhimit brenda NJSO-së duhet të përshpejtohet dhe në këtë mënyrë të evitohen diferencat e mëdha në menaxhmentin e NJSO-së lidhur me shtrirjen e kontrollit dhe plotësimin e pozitave me grada adekuate.
3. Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, menaxhmentin policor që gjatë implementimit të reformës për NJSO-të të angazhohet edhe për formimin e NJRSH-ve jo vetëm në aspektin strukturor por edhe atë praktik duke u përcjellur me aktet e nevojshme rregullative.
4. Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, fuqishëm menaxhmentin e PK-së që të filloj aplikimin e parimeve dhe procedurave të sigurimit shëndetësor për pjesëtarët e Njësive Speciale konform (PSO, neni.15), krijimin e kushteve të cilat duhet të përmbushen për zhvillimin e trajnimeve të domosdoshme (PSO, neni. 17.1).
5. Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, që aftësitë dhe njohuritë individuale të fituara gjatë trajnimit, të vlerësohen përmes testeve standarde, në drejtim të rritjes së efikasitetit të performancës së NJSO-së.
6. Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, menaxhmentin e DNJS-së që të organizoj dhe mbaj trajnime për ri-certifikim të rregullt të trajnerëve, ri-certifikim sipas Parimit 8.14 si dhe rregullave të parapara për ri-certifikim me armë të gjata.
7. Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Drejtorit të Divizionit të Njësive të Specializuara, edhe pse deri në fund të vitit 2014 pritet që të centralizohet kjo njësi (NJSO) vetëm në një strukturë unike, që në të ardhmen t'u jepet prioritet kurseve obligative në mënyrë që i gjithë personeli i NJSO-së të trajnohen.
8. Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon që të krijohet një formë unike për të gjitha rajonet ku do të regjistroheshin armët dhe pajisjet tjera në mënyrë të saktë dhe të bëhet inventarizimi i çdo pajisje që posedon secila njësi (blerjet, donacionet, pajisjet me afat të skaduar, etj.).

3) Inspektimi i Njesisë Speciale Intervenuese- NJSI

Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka bërë inspektim të jashtëzakonshëm në Njësinë Speciale Intervenuese të PK-së.



Qëllim i inspektimi ishte vlerësimi i kryerjes së detyrave nga personeli kompetent i angazhuar në NJSI, menaxhimi i NJSI në përputhje me legjislacionin në fuqi, të jepet një vlerësim objektiv mbi respektimin e dispozitave ligjore, procedurave dhe rregullave, përmbushjen e objektivave kundrejt të priturave.

Rekomandimet kryesore:

1. IPK-ja rekomandon Drejtorit të Divizionit të Njësive të Specializuara implementimin e Strukturës Organizative të datës 20/05/2012, e aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës në lidhje me personelin e përgjithshëm, vendosjen e personave me grada nëpër pozita në harmoni me strukturën në NJSI.
2. IPK-ja rekomandon Komandantit të njësisë që në bazë të analizimit të faktorëve dhe testimit të nxjerrë në formë të shkruar parametrat që përcaktojnë kohën e shpejtësisë së mobilizimit dhe reagimit të kësaj njësie në përgjigje të rasteve dhe operacioneve policore, duke e konsideruar seriozisht që kjo njësi të jetë në detyrë 24 orë, pra të punoj në tre ndërrime.
3. IPK-ja, rekomandon Drejtorit të DNJS-së të PK-së t'iu dalë në përkrahje operatorëve të NJSI-së të gjitha rajoneve nga vinë në lidhje me transportin, të shtohet numri i veturave në thirrje me qëllim të ngritjes së performancës, sigurisë, motivimit në NJSI.
4. IPK-ja, rekomandon U.D Drejtorit të Divizionit të Njësive të Specializuara, në të ardhmen të veproj në bazë të kërkesës së Departamentit të Trajnimeve dhe të aplikoj me përpikëri të plotë P-8.16. listën e nominuar të zyrtarëve policor për trajnim jashtë vendi DNJS ta dërgoi te Departamenti i Trajnimeve për procedim të mëtutjeshëm.
5. IPK-ja, rekomandon Drejtorit të Drejtorisë së Njësive të Specializuara që të rivlerësoj lokacionin në të cilin gjendet NJSI duke marrë në konsideratë ruajtjen/fshehjen e identitetit të operatorëve gjatë operacioneve të ndryshme që kryen NJSI, të kujdeset që pajisjet që ka në përdorim kjo njësi të jenë të kualitetit më të lartë dhe në gjendjen më të mirë si dhe në përputhje me pikën 10 të PSO-së së NJSI-së, të bëjë furnizimin me rroba civile dhe sportive me qëllim të ruajtjes së shëndetit gjatë aktiviteteve fizike.
6. IPK-ja, rekomandon Drejtorit të Drejtorisë së Njësive të Specializuara ti zbatojë në praktikë rekomandimet e IKSHPK në Kampin "Vrella" me qëllim të ruajtjes së shëndetit të pjesëtarëve të NJSI të vendosur në këtë kamp.
7. IPK-ja, rekomandon Drejtorit të Drejtorisë së Njësive të Specializuara në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse në kuadër të PK-së të marrin masat e nevojshme për ngritjen dhe përmirësimin e nivelit të sigurisë në Kampin "Vrella", pasi që ky kamp me njësitë e vendosura aty është i një rëndësie vitale për vendin.

4) Inspektimi i Qendrave të Mbajtjes në Policinë e Kosovës

Inspektorati Policor i Kosovës në bazë planit vjetor të inspektimeve 2013, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, ka bërë inspektim të rregullt në Qendrat e Mbajtjes së Policisë së Kosovës.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i kryerjes së detyrave nga personeli kompetent i angazhuar në menaxhimin e Qendrave të Mbajtjes në Policinë e Kosovës në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimin e kushteve materiale dhe të sigurisë në këto qendra dhe të ipet një mendim objektiv për respektimin e dispozitave ligjore, procedurave, rregullave.



Rekomandimet kryesore:

1. Inspektorati Policor rekomandon zyrtarëve përgjegjës të Qendrave të Mbajtjes që të përkujdesën për pastërtinë e dritareve, për shkak të përmirësimit të ndriçimit natyral.
2. Inspektorati Policor rekomandon Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve që të gjej mundësinë për të ndërtuar murin ndarës në tualete tek ato dhoma të ndalimit tek të cilat tualetet nuk ofrojnë privatësinë.
3. Inspektorati Policor rekomandon Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve që të shqyrtoj mundësinë e përmirësimit të kushteve në zyrat e monitorimit.
4. Inspektorati Policor rekomandon Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës që gjatë përpilimit të strukturës organizative për Qendra të Mbajtjes të merret parasysh numri i personave të ndaluar në Qendrat e Mbajtjes, si dhe numri i zyrtarëve policorë me të cilët disponon stacioni përkatës.
5. Inspektorati Policor rekomandon Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve që sipas kërkesave nga Stacionet Policore të bëjë riparimin, ose zëvendësimin e sistemit të video kontrollit (kamerave) dhe sipas mundësive zëvendësimin e vendeve të montimit të kamerave.
6. Inspektorati Policor i rekomandon Drejtorisë për Menaxhimin e objekteve që të riparoj grilat e dëmtuara dhe të zëvendësojë ato të cilat janë të ndërtuara nga materiali i dobët.
7. Inspektorati Policor rekomandon Qendrat e Mbajtjes që të pajisen me sirtarët (sefat) e sigurt të cilët kanë mundësinë e mbylljes dhe ruajtjen e sendeve të marra nga të ndaluarit.
8. Inspektorati Policor rekomandon përgjegjësit për Qendrat e Mbajtjes që të ruajnë edhe një kopje të dosjeve fizike në një vend tjetër.
9. Inspektorati Policor rekomandon Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve që sipas kërkesave nga Stacionet Policore të bëjë riparimin, ose zëvendësimin e kroit dhe lavamanit.
10. Inspektorati Policor fuqishëm rekomandon Stacioneve Policore që të hartojnë planin e evakuimit në nivel të Qendrave të Mbajtjes.

5) Inspektimi i Dhomave të Dëshmime në Policinë e Kosovës

Inspektorati Policor i Kosovës ka autorizuar inspektimin e dhomave të dëshmime për të vlerësuar kryerjen e detyrave nga përgjegjësit e këtyre dhomave.

Qëllimi i organizimit dhe funksionalizimit të këtij inspektimi ka qenë që të vlerësohet kryerja e detyrave në përputhje me legjislacionin, të vlerësohet niveli i sigurisë së dhomave të dëshmime, të jepet një mendim objektiv mbi respektimin e dispozitave ligjore, procedurave dhe rregullave në fuqi.



Rekomandimet kryesore:

1. IPK-ja i rekomandon drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetës që të intensifikojë bashkëpunimin me drejtorin e Departamentit për Hetime si dhe Drejtorët Rajonalë në mënyrë që Departamenti për Shërbime Mbështetëse të pajisë Dhomat e Dëshmime me rafte lëvizëse, kontenier, kuti standarde, frigorifer, shuarës të zjarrit dhe pajisje tjera adekuate për secilën dëshmi.
2. IPK-ja i rekomandon drejtorët rajonal policor (DRP-Ferizaj, DRP-Gjilan) që të ndërmarrin masat adekuate për të eliminuar lagështinë në dhomat e dëshmime që ky problem është evident.
3. IPK-ja rekomandon Drejtorëve Rajonal Policor të DRP-Mitrovicë dhe DRP-Gjilan që në Dhomat e Dëshmime ku dyert kanë kapëset nga ana e jashtme të vendosin mjete shtesë për sigurimin e tyre.
4. IPK-ja u rekomandon zyrtarëve të angazhuar në Dhomat e Dëshmime që në Regjistrin e Dëshmime dhe bazën elektronik të të dhënave, si dhe në kabina, rafte, sirtarë dhe kuti metalike të prezantojnë edhe informacionin mbi vendndodhjen e dëshmime (lokacionin e saktë të deponimit).
5. IPK-ja u rekomandon zyrtarëve të Dhomës së Dëshmime që me rastin e pranimit të dëshmime nga hetuesit e rastit të sigurohen se dëshmitë janë të paketuara në paketime standarde, të cilat ruajnë dëshmitë nga dëmtimet e mundshme apo humbjet.
6. IPK-ja u rekomandon zyrtarëve të Dhomës së Dëshmime që me rastin e regjistrimit të sendeve/dëshmime të bëjë plotësimin e të dhënave në mënyrë ekuivalente edhe në data bazën elektronike.
7. IPK-ja rekomandon menaxhmentin e lartë që të merr masa për të siguruar qese letre me shënime në gjuhët zyrtare si dhe të obligojë zyrtarët e dhomës së dëshmime për të plotësuar me shënime pjesën e dytë të qeses së letrës për tu siguruar se ka shënime sa i përket zinxhirit të ruajtjes (from- to- date).
8. IPK-ja rekomandon Drejtorinë për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore të angazhohet në përpilimin e një dokumenti të ri që do të rregullonte në përpikëri punën në Dhomat e Dëshmime.
9. IPK-ja rekomandon menaxhmentit të lartë policor që të kenë kujdes sa i përket mekanizmit të kontrollit të brendshëm dhe të angazhohet për të mbikëqyrur dhe të kërkojë llogaridhënie sa i përket raportimeve lidhur me inventarizimin, revizionimin dhe inspektimin e dhomave të dëshmime.
10. IPK-ja rekomandon menaxhmentit të lartë të angazhoj Divizionin e Trajnimeve që të organizojnë trajnime adekuate për zyrtarët policor të Dhomave të Dëshmime.

VII. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE

Departamenti i Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse (DASHM) pranë Inspektoratit Policor të Kosovës ka rol mbështetës dhe shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punëve dhe arritjen e objektivave të Inspektoratit Policor të Kosovës.

DASHM përmes personelit të saj përkujdeset që t'u ofroj departamenteve operative mbështetje materiale, logjistike, teknike si dhe të gjitha shërbimet tjera administrative në mënyrë që të arrihen objektivat ligjore.

Në fushën e trajnimeve janë realizuar gjithsej 12 trajnime në të cilat kanë qenë të përfshirë një numër i konsideruar nga personeli operativ (inspektor dhe hetues) dhe nga punonjësit e administratës (shih tabelën nr. 14).

Tabela 7.

| Nr | Lloji i trajnimit | Organizata | Data/muaji | Ditë | Zyrt. |
|----|--|------------|----------------|------|-------|
| 1 | Shkrimi i raporteve – kurs i avancuar | ICITAP | 13-24/05 | 10 | 19 |
| 2 | Hetimi i përbashkët i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore | ICITAP | 17-19/06 | 3 | 2 |
| 3 | Detyrat e veçanta kriminalistike | RH-MUP | 20-24/05 | 5 | 1 |
| 4 | Ndryshimet në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale | ICITAP | 29/04 | 1 | 1 |
| 5 | Teknikat e avancuara të hetimeve financiare | MF-USA | 09-13/09 | 4 | 3 |
| 6 | Hetimet e brendshme – kurs i avancuar | ICITAP | 23,09-04,10 | 10 | 17 |
| 7 | Kursin e Ri-certifikimit | AKSP | 16-18/23-25/10 | 3 | 42 |
| 8 | Ngritje e nivelit profesional të IPK-së | KONTO-Veb | 4-5-11-12/13 | 4 | 20 |
| 9 | Kursi trajnimi ndihmës së parë | AKSP | 16 – 20.12/13 | 5 | 3 |
| 10 | Kursi i gjuhës angleze | ICITAP | 16.09-30.12/13 | Muaj | 7 |
| 11 | Moduli i Blerjeve | MF | 02.07.2013 | 1 | 1 |


Bazuar në Ligjin Nr.04/L-165, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, IPK, ka të aprovuar këtë ndarje buxhetore:

Tabela 8.

| Kategoria Ekonomike | Sipas Ligjit Nr.04/L-165 | Sipas SIMFK | Shpenzimet | Përqindja |
|---------------------|--------------------------|---------------------|-------------------|--------------|
| Paga dhe Mëditje | 537,899.00 | 537,899.00 | 478,078.38 | 88.87 |
| Mallra dhe Shërbime | 383,328.00 | 373,328.00 | 295,422.72 | 79.13 |
| Shpenzime Komunale | 11,000.00 | 21,000.00 | 12,723.47 | 60.59 |
| Projekte Kapitale | 180,000.00 | 144,000.00 | 122,579.03 | 85.12 |
| Totali | 1,112,227.00 | 1,076,227.00 | 908,803.60 | 84.44 |

Në tabelën dhe grafikun e poshtëshënuar janë të dhënat e ndarjeve finale buxhetore, shumat e shpenzuara, mbetjet dhe realizimi për secilën Kategori Ekonomike:

Diagrami 11.



Bazuar në të dhënat e prezantuara më lartë, objektivat e parapara buxhetore të IPK-së janë realizuar me sukses. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2013, është bërë finalizimi i punimeve dhe transferi në objektin e ri të IPK-së, si dhe realizimi me sukses i projekteve kapitale të parapara për vitin 2013.

**PROGRAMI I TRAJNIMIT PRAKTIK NË IPK
PROGRAM PËR ZHVILLIMIN DHE NGRITJEN E STANDARDEVE PROFESIONALE
PER ZYRTARËT E RINJ**



Pas përfundimit të trajnimit bazik në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në Vushtrri, 15 zyrtarët e IPK-së kanë filluar Programin e Trajnimit Praktik.

Me vendim të Kryeshefit ekzekutiv të IPK-së ishte themeluar grupi punues për përgatitjen e një Programi të trajnimit fushor për zyrtarët e rinj që i bashkëngjiten IPK-së.

Duke u bazuar në praktikat më të mira grupi punues përgatiti një program që i përshtatet nevojave të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Trajnimi praktik zgjat 6 muaj dhe gjatë kësaj kohe zyrtarët e rinj që i nënshtrohen këtij trajnimi duhet të tregohen se kanë arritur sukses të bëhen të pavarur.

Qëllimi i këtij Programi është t'i qartësojë procedurat dhe udhëzimet për trajnimin e zyrtarëve të IPK-së praktikant të posa-certifikuar në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Po ashtu si qëllim i Programit është që të lehtësojë kalimin e kandidatit nga ambienti shkollor i mësimin teorik në atë praktik ku nevojitet aplikimi i drejtpërdrejtë i aftësive gjatë kryerjes së detyrës, duke përfshirë këtu dy fusha të gjëra veprimi **Hetimin dhe Inspektimin.**

INAUGURIMI I OBJEKTIT TË RINOVUAR TË INSPEKTORATIT POLICOR TË KOSOVËS



Muaji maj i vitit 2013 shënoi inaugurimin e objektit të rinovuar të IPK-së.

Projekti i renovimit të objektit ka filluar në vitin 2012 për të finalizuar një vit më vonë dhe ofron kushte më të mira për punë me një hapësirë prej rreth 2700 metra katrorë.

Përmirësimi i kushteve të punës për zyrtarët e IPK-së është një prej faktorëve që do të ndikojë pozitivisht në përmbushjen e objektivave ligjore të parapara me planin zhvillimor dhe strategjik të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Objekti i ri i rinovuar është në përputhje me të gjitha standardet evropiane, me një hapësirë prej 2.700 metrave katrorë, 82 zyrave, sallave dhe hapësirave të tjera për punë.

Ky objekt ndodhet në afërsi të shkollës fillore përgjatë rrugës kryesore të Hajvalisë, rrugës magjistrale Prishtinë Gjilan, kthesa te tabela për në hyrjen e fshatit Hajvali.

VIII. ZHVILLIMI I BASHKËPUNIMIT ME QYTETARËT DHE ORGANIZATAT VENDORE

Zhvillimi i marrëdhënieve me publikun dhe fuqizimit të bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare është i rëndësishëm së veçantë për IPK-në. Gjatë këtij viti, IPK-ja ka pasur një mori aktivitete në vazhdim të përpjekjeve për të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me qytetarë dhe partnerë të ndryshëm, me organizata qeveritare e jo qeveritare dhe me media.

a). Bashkëpunimi me Prokurorinë

Bashkëpunimi me Prokurorinë Publike është i paraparë edhe me legjislacionin në fuqi. Gjatë punës së përditshme, punonjësit e strukturës hetimore dhe menaxhmenti i saj kanë krijuar lidhje shumë të ngushta bashkëpunimi në drejtim të luftimit të korrupsionit dhe veprave tjera penale në polici. Me kërkesën e menaxhmentit të IPK-së drejtuar Kryeprokurorit të Shtetit është caktuar një Prokuror i veçantë për të punuar me IPK-në dhe kjo është arritur deri tani në pesë Prokurori: Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj, Prizren dhe Gjakovë.



Inspektorati Policor i Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit të Republikës së Kosovës kanë krijuar raporte të partneritetit dhe bashkëpunimit në luftën e dukurive negative të cilat hasen në radhët e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, e në veçanti në luftimin e korrupsionit përmes, shkëmbimit të informacioneve lidhur me dyshimin e implikimit në veprimtari penale të zyrtarëve policor, bashkëpunimin në hetimin e rasteve që rezultojnë me veprime kriminale, dhënien e autorizimeve nga Prokuroria për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara hetimore nga ana e IPK-së, ndihmë dhe asistencë gjatë procesit të hetimor si dhe ofrimin e këshillave të ndërsjella në zgjidhjen e problemeve të ndryshme që kanë të bëjnë me luftimin e dukurive negative në Policinë e Kosovës.

Po ashtu bashkëpunim të mirë IPK-ja ka edhe me shërbimet administrative të Prokurorive, ku ky shërbim konsiston në dhënien e informacioneve të sakta dhe të shpejta lidhur me rastet të cilat IPK-ja i ka proceduar në Prokuroritë kompetente.

b). Bashkëpunimi me Policinë

Bashkëpunim me Policinë e Kosovës është orientuar në dhënien e kontributit për ngritjen e performancës së dy agjencive dhe ofrimin e ndihmës reciproke, teknike, operative dhe mbështetëse, të paraparë edhe me legjislacionin në fuqi. Këtij bashkëpunimi i kanë prirë shumë takime që janë zhvilluar për të diskutuar çështje që ndërlidhen me fushëveprimin e Inspektoratit Policor.



Përveç takimeve të rregullta, bashkëpunimi me Policinë e Kosovës ka qenë

në baza ditore duke shkëmbyer informata dhe duke përkrahur njeri tjetrin në luftimin e dukurive negative brenda Policisë së Kosovës.

Në shumë raste janë zhvilluar hetime e operacione të përbashkëta të cilat kanë rezultuar me një koordinim shumë të mirë në zgjedhjen e rasteve dhe zbatimin e mandateve ligjore të këtyre dy institucioneve (për më shumë shih shembullin e rastit faqe 24 në këtë raport vjetor).

Në kuadër të bashkëpunimit me Policinë e Kosovës, duhet të theksohet edhe qasja proaktive që ka PK-ja në raport me iniciimin e rasteve dhe ndërmarrjes së veprimeve konkrete për të ngritur nivelin e disiplinës në organizatë dhe ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit.

Në total gjatë vitit 2013 ishin 111 ankesa apo 11% i totalit të ankesave të trajtuara në IPK që janë iniciuar nga vet Policia e Kosovës ndaj zyrtarëve të saj. Kjo përqindje flet për angazhimin e shtuar të Policisë në drejtim të ngritjes së cilësisë së kontrollit të brendshëm dhe përmirësimit të performancës së PK-së.

Inspektorati Policor vlerëson lart nivelin e bashkëpunimit me Policinë e Kosovës duke synuar që i njëjti të fuqizohet akoma më shumë në vitet vijuese bazuar në autorizimet dhe kompetencat ligjore të IPK-së në drejtim të rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit të policisë.

c). Bashkëpunimi me Institucionin e Avokatit të Popullit

Inspektorati Policor i Kosovës dhe Avokati i Popullit si dy institucione të pavarura, kanë një bashkëpunim të ngushtë në mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës.



d) Marrëdhëniet me publikun



Varësisht sipas nevojave operative në teren, në bashkëpunim me departamente të ndryshme në kuadër të IPK-së janë publikuar komunikata për media, janë organizuar takime e konferenca të ndryshme për media ku janë pasqyruar rezultatet e arritura nga IPK-ja. Një ndër angazhimet e IPK-së për vitin 2013 në kuadër të angazhimeve për fuqizimin e transparencës ishte fillimi i publikimit të revistës së IPK-së "Integriteti". Përveç informimit të brendshëm dhe atë kryesisht përmes shkrimeve të ndryshme të botuara në


revistën zyrtare të IPK-së, revista “Integriteti” konsiderohet si një projekt i rëndësishëm edhe për informimin e jashtëm e sidomos të zyrtarëve të Policisë së Kosovës por edhe partnerëve vendorë e ndërkombëtarë për angazhimet e IPK-së. Aktivitetet e deritashme që janë realizuar gjatë vitit 2013 nga IPK-ja në drejtim të fuqizimit të transparencës dhe bashkëpunimit me qytetarë janë:


- publikimi i rasteve që zgjojnë interesin e opinionit publik (kryesisht përmes komunikatave për media dhe konferencave;
- dhënia e deklaratave për mediat, pjesëmarrja në debate televizive, emisione të karakterit informativ etj;
- angazhime shtesë në fushën e marrëdhënieve me publikun;
- përgatitja, editimi dhe publikimi i revistës “Integriteti”
- përgjigjja në kërkesat e adresuara nga mediat e ndryshme në çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e IPK-së etj.

Inspektorati Policor i Kosovës në vazhdimësi i ka njoftuar mediet për punën dhe aktivitetet që janë zhvilluar përmes formave të ndryshme me qëllim që të tregoj transparencë dhe informim të duhur qytetarëve. Duke qenë i përkushtuar në ngritjen e transparencës në raport me qytetarët, IPK-ja ka realizuar shumë paraqitje publike.

Rol me rëndësi në njoftimin e publikut me punën e IPK-së ka luajtur edhe faqja zyrtare elektronike e cila ka qenë një dritare e hapur për të gjithë ata që kanë qenë të interesuar për aktivitetet dhe raportimet për raste të ndryshme.

Një ndër qëllimet strategjike të Inspektoratit Policor është edhe përqendrimi për të siguruar shërbim të mirë për qytetarët duke ofruar një shërbim të kompletuar, konciz e korrekt i cili kryhet me përkushtim e me mirësjellje.






Në kuadër të kësaj, rreth dy vite më parë ka hyrë në funksion edhe një mënyrë shtesë e kontaktit të qytetarëve me IPK-në - linku për ankesa i cili pasi të klikohet jep mundësinë qytetarëve për plotësimin e të dhënave të tyre lidhur me ankesën e mundshme. Gjatë 2013-ës në total 45 ankesa nga qytetarët janë proceduar përmes uebfaqes zyrtare të IPK-së ose përmes email adresës zyrtare info.ipk@rks-gov.net.

Përveç ueb faqes së IPK-së, një rol të rëndësishëm për informimin e qytetarëve ka pasur edhe përdorimi i rrjeteve sociale si Facebook dhe Twitter.

Nga statistikatat zyrtare të adresës zyrtare në Facebook vërehet ngritje e vizitorëve në adresën zyrtare të IPK-së në këtë rrjet social. Grupmosha që më së shpeshti viziton adresën zyrtare të IPK-së është ajo nga 25-34 vjet me 34% e përcjellë me grupmoshën 18-24 vjet që arrin në 19%. Në rritjen e numrit të vizitorëve në këtë rrjet social ka ndikuar azhurnimi me kohë dhe publikimi i foto lajmeve si dhe aktiviteteteve të ndryshme të IPK-së.

Krahas angazhimeve në fushën e marrëdhënieve me publikun si fokus në 2013-ën ishte edhe ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të IPK-së si dhe avancimi i bashkëpunimit në mes medieve dhe IPK-së. Në kuadër të kësaj vlen të theksohet trajnimi i organizuar me ndihmën e ICITAP-it amerikan për MPB-në dhe agjencitë e saj duke trajtuar komunikimin strategjik dhe komunikimin në situata krize.



Në këtë trajnim ligjëratat janë mbajtur nga specialistja amerikane për publikime dhe komunikime, Marguerite H. Sullivan. Në këtë trajnim morën pjesë zyrtarët e zyrave për informim publik të MPB-së, Inspektoratit Policor të Kosovës, Policisë së Kosovës, si dhe zyrtarët e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike. Ky trajnim kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve në këtë fushë si dhe bashkëpunimin në mes të MPB-së dhe agjencive vartëse të saj.

XI. BASHKËPUNIMI I IPK-së ME ICITAP-in AMERIKAN

Për gati një dekadë pas luftës dhe fillimit të ndërtimit të institucioneve qendrore të vendit dhe nxjerrjes së ligjeve të reja shumë donatorë të huaj kanë dhënë kontributin e tyre përmes këshillimeve, trajnimeve të ndryshme për IPK-në. Me kalimin e kohës disa kanë përfunduar mandatet e tyre (p.sh OSBE) dhe janë larguar ndërsa disa kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontributin e tyre në ngritjen e efikasitetit tonë për të qenë të përgatitur, profesional dhe objektiv në kryerjen e detyrave tona.



Zhvillimi profesional i IPK-së ka vazhduar edhe gjatë vitit 2013, bashkëpunimi i IPK-së me ICITAP-in Amerikan ka qenë dhe është i rëndësishëm së veçantë dhe ka karakter shumë dimensional. Ky bashkëpunim, përveç natyrës këshillëdhënëse dhe mbështetëse, po sjell dobi të drejtpërdrejt në ndërtimin e karakterit dhe vetëbesimit të punonjësve të IPK-së.

IPK në vitin 2013 ka përfituar nga ICITAP-i si në aspektin marrjes së këshillave dhe dijeve të reja e të avancuara nga ekspert kompetent dhe me përvojë që vinin organizatat me repute botërore në fushën e zbatimit të ligjit përmes trajnimeve konkrete nga fushat e nevojshme për ngritjen e cilësisë së punës në IPK dhe donacioneve të ndryshme me pajisje të nevojshme për të kryer mandatet dhe misionin e IPK-së me një kualitet të lartë.

Takimet e rregullta të menaxhmentit të IPK-së me përfaqësuesit e kësaj organizate, përkushtimi dhe puna e tyre e pa lodhshme, ka bërë që IPK-ja të njihet si organizatë e cila dëshmon para qytetarëve të saj dhe të tjerëve se është një organizatë e trajnuar mirë, e përgatitur për t'u ballafaquar me sfida, dhe objektive për të kërkuar të vërtetën gjatë ushtrimit të funksioneve të saj. Sikurse edhe vitet tjera, ICITAP, edhe këtë vit ka mbetur si organizata më përkrahëse për IPK-në.



Kontributi i kësaj organizate ka qenë prioritar dhe i pa zëvendësueshëm në ofrimin e këshillave dhe ekspertizës në nxjerrjen dhe rishikimin e udhëzimeve administrative që burojnë nga Ligji për IPK-në, Udhëzime Administrative të cilat kanë bërë një riorganizim konkret duke ndarë me qartësi detyrat dhe përgjegjësitë e IPK-së të cilat garantojnë efikasitet dhe ngritje të cilësisë së punës së IPK-së.

Trajnimet të cilat i ka ofruar këtë vit ICITAP-i për IPK-në kanë qenë të pazëvendësueshme në ngritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të IPK-së duke ofruar programe dhe ekspertët më të mirë në fushën e zbatimit të ligjit. Trajnimet të cilat ka ofruar ICITAP për IPK-në kanë qenë mëse të nevojshme dhe të qëlluara për të arritur përmbushjen e misionit të IPK-së



Ndër trajnimet e rëndësishme të realizuara gjatë 2013-ës ishte trajnimi dy javor “**për hetime të brendshme**” dhe trajnimi dy javor “Teknikat e avancuara për intervistim dhe shkrim të raporteve” të cilat IPK-ja i vlerëson shumë lartë dhe synon ti përfshij në kuadër të PSO-ve të saj në mënyrë që ato të jenë të obligueshme pasi konsiderohet se si të tilla do të kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së punës së IPK-së.

Pjesëtarët e Inspektoratit Policor të Kosovës kanë qenë pjesëmarrës edhe në shumë trajnime të tjera të organizuara nga ICITAP-i si trajnimi “Hetimi i përbashkët i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore”, “Ndryshimet në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale”, “Teknikat e avancuara të hetimeve financiare” etj, të cilat kanë ndikuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të IPK-së (shih tabelen nr 9 si me poshte).

Tabela 9

| Nr | Lloji i trajnimit | Organizata | Ditë | Zyrt. |
|----|--|------------|------|-------|
| 1 | Shkrimi i raporteve - kurs i avancuar | ICITAP | 10 | 19 |
| 2 | Hetimi i përbashkët i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore | ICITAP | 3 | 2 |
| 3 | Ndryshimet në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale | ICITAP | 1 | 1 |
| 4 | Teknikat e avancuara të hetimeve financiare | MF-USA | 4 | 3 |
| 5 | Hetimet e brendshme - kurs i avancuar | ICITAP | 10 | 17 |
| 6 | Kursi i gjuhës angleze | ICITAP | Muaj | 7 |

Ekspertët nga ICITAP-i kanë treguar gatishmëri të plotë në mbështetjen e vazhdueshme për të dhënë këshillat e nevojshme duke qenë të përkushtuar në ofrimin e praktikave të vendeve të tyre, të cilët kanë pasur suksese të dukshme në luftën kundër korrupsionit dhe keq menaxhimit policor.

Duke parë një gatishmëri për bashkëpunim nga ana e kësaj organizate, IPK-ja ka vendosur në njërin nga objektivat strategjike të saj edhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me këtë organizatë.

X. BASHKËPUNIMI I IPK-së ME EULEX-in DHE OSBE-në

g) Bashkëpunimi me EULEX-in

Misioni Evropian për Sundimin e Rendit dhe Ligjit – EULEX, ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në IPK. Bashkëpunimi ka qenë i një niveli të lartë, ku vlerësohet shumë kontributi i tyre këshillëdhënës si në fushën e hetimeve po ashtu edhe në atë të inspektimeve. Një falënderim i madh u shkon edhe Prokurorëve të EULEX-it të cilët kanë ndihmuar në disa raste të veprave penale, dhe pa asnjë hezitim kanë përkrahur IPK-në në çdo fazë të hetimeve.



Takimet e shumta që janë mbajtur edhe në mes të monitoruesve të këtij misioni dhe zyrtarëve të lartë të IPK-së, duke ofruar përvojat e tyre në çështjet me interes të dyanshëm, me qëllimin e vetëm për të arritur rezultate më të mira në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. IPK ka çmuar punën e këtij misioni në përmirësimin e rendit dhe ligjit në Kosovë.

Kontributi i këtij misioni ka qenë i theksuar përveç në ofrimin e këshillave dhe ekspertizës në çështje të ndryshme në zbatimin e funksioneve të IPK-së edhe në nxjerrjen dhe rishikimin e udhëzimeve administrative që burojnë nga Ligji për IPK-në si dhe në ndihmën e pa kursyer të ekspertëve të saj në hartimin dhe rishikimin e Procedurave Standarde të Veprimit për IPK-në.

h). Bashkëpunimi me OSBE-në

Misioni i OSBE-së në Kosovë edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimin me Inspektoratin Policor të Kosovës dhe atë kryesisht përmes organizimeve të konferencave të ndryshme dhe seminareve që në fokus kishin përmirësimin e fushës së marrëdhënieve me publikun. IPK-ja mori pjesë në konferencën e organizuar nga OSBE-ja me titull “Përmirësimi i informimit të banorëve përmes medieve mbi çështjet e sigurisë” që u mbajt në Prizren. Misioni i OSBE-së organizoi edhe një konferencë për zyrtarët për informim të shërbimeve policore dhe agjencive mbikëqyrëse të policisë nga rajoni për t’ju ndihmuar në vendosjen e kontakteve dhe bashkëpunimit.



Në këtë konferencë tre ditore është diskutuar lidhur me format e komunikimit me media dhe publikun në organizata prej nga vijnë përfaqësuesit shkëmbimi i përvojave dhe mundësitë e bashkëpunimit në mes organizatave policore të vendeve pjesëmarrëse.

IPK do të vazhdojë të jetë pjesë e këtyre nismave nga kjo organizatë aty ku konsiderohet se kontributi jonë mund të jetë i nevojshëm.

XI. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I IPK-SË

IPK-së mori pjesë këtë vit në Konferencën e 13-të me radhë të EPAC-ut (European Partners Against Corruption - Partnerët Evropian Kundër Korrupsionit) që u mbajt në Krakow të Polonisë më 13-15 nëntor 2013. EPAC-u themelua në vitin 2004 me qëllim që të kontribuoj në fushën e mbikëqyrjes policore dhe luftës globale kundër korrupsionit.



Pamje nga Kongresi i EPAC-ut – Krakow, Poloni

Mbi 65 organizata - institucione të mbikëqyrjes policore dhe antikorrupsionit të shteteve evropiane duke përfshirë këtu edhe Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) morën pjesë në këtë konferencë të EPAC-ut. Gjatë katër sesioneve plenare në këtë konferencë u trajtuan tema të rëndësishme si: rregulloret e integritetit brenda policisë, korrupsioni dhe luftimi i tij në shërbimet policore, testi i integritetit -korniza ligjore etj.

Prezantimet nga delegatët ngritën disa çështje të rëndësishme dhe aktuale siç është propozimi i Komisionit Evropian lidhur me Zyrën e Prokurorit Publik Evropian e deri te temat që ndërlidhen me agjencitë e mbikëqyrjes policore. IPK vlerësoi lart rëndësinë e shkëmbimit të përvojave në mes institucioneve të mbikëqyrjes policore të shteteve evropiane.

IPK ka qenë pjesëmarrëse edhe në seminarin teknik në Slloveni (28-29 tetor 2013) të organizuar nga EPAC ku është diskutuar për rolin e përdorimit të teknologjisë informative në luftën kundër korrupsionit.

Fundi i tetorit shënoi edhe mbajtjen e kongresit Law Tech Europe Congress 2013 në Republikën Çeke ku pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues nga Inspektorati Policor i Kosovës. Nga pjesëmarrësit ky kongres u vlerësua lart si për shkëmbimin e përvojave në fushën e krimit



Foto e përbashkët nga delegatët e shteteve të ndryshme pjesëmarrës në konferencën e 13-të të EPAC-ut ku edhe Kosova përfaqësohej nga delegacioni i IPK-së.

kompjuterik ashtu edhe të mundësisë së njoftimit lidhur me zhvillimet e fundit në teknologjinë informative.

IPK morri pjesë në konferencën e katërt me radhë në Maqedoni (5-7 nëntor) i organizuar nga misioni i OSBE-së dhe DCAF-i për integritetin e policisë, përgjegjshmërinë dhe mbikëqyrjen e jashtme. Në këtë konferencë pjesëmarrës ishin menaxhmenti i lartë i IPK-së.

Sfera e bashkëpunimit ndërkombëtar do të vazhdoj edhe vitin vijues si përpjekje për të ngritur nivelin e bashkëpunimit të Inspektoratit Policor të Kosovës dhe organizatave si motra të IPK-së.

XII. PËRFUNDIME

IPK-ja këtë vit ka hyrë në një fazë kritike të zhvillimit të saj strategjik duke iniciuar reforma të thella strukturore, duke përgatitur PSO të reja për të cilat ne besojmë që do të ngrisin llogaridhënien, mirë menaxhimin, do të përmirësojnë performancën dhe do të ngritin akoma krenarinë e punonjësve tanë. Por prapë mbetet ende punë për tu bërë.

Gjatë këtij viti përkushtimi dhe profesionalizmi ynë lidhur me përmbushjen e mandateve ligjore - hetimin e veprave penale, shkeljeve disiplinore, inspektimin e punës policore nuk është luhatur asnjëherë.

Barra e zbatimit të mandateve ligjore me ligjin e IPK-së në përforcimin e rendit dhe ligjit është gjetur brenda një 4% të punonjësve të Policisë së Kosovës që kanë qenë subjekt hetimeve nga IPK-ja ndërsa për Inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme dyert kanë qenë të hapura në çdo fushë të inspektuar menaxhmentit të PK-së.

Angazhimet e IPK-së në vitin 2014 do të jenë në drejtim të ushtrimit të përgjegjësive në mënyrë të organizuar, sistematike dhe të planifikuar mirë duke siguruar plane pune të studiuara mirë, të mbështetura në indikatorët e vlerësimit të riskut. Në përputhje me ligjin dhe standardet më të avancuara ndërkombëtare do të punojmë që të ndihmojmë Policinë e Kosovës që të avancoj në performancën e saj, të garantoj siguri dhe rend për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ne i jemi mirënjohës Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës dhe shpresojmë që puna jonë si nga ana hetimore ashtu edhe nga ana inspektuese të shërbej Policisë së Kosovës në arritjen e mandatit të saj ligjor dhe bashkërisht të ofrojmë qytetarëve nivelin e sigurisë të cilin ata duhet ta gëzojnë ndërsa ne si institucione në shërbim të qytetarëve të kemi besimin e tyre të cilin ne duhet ta meritojmë.

PËRKUFIZIMET

Shprehjet e përdorura në këtë raport kanë këtë kuptim:

HETUES – personeli i Inspektoratit Policor të Kosovës që zhvillon hetime penale ndaj punonjësve të Policisë së Kosovës, përfshirë edhe hetimet mbi incidentet e profilit të lartë disiplinor si dhe hetimin disiplinor të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv;

INSPEKTORËT – personeli i Inspektoratit Policor të Kosovës që zhvillon inspektime në Policinë e Kosovës;

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme;

MINISTRI – Ministri i Punëve të Brendshme;

IPK - Inspektorati Policor i Kosovës;

PUNONJËS I POLICISË SË KOSOVËS - tërë personeli i Policisë që përfshin zyrtarin policor dhe stafin civil të Policisë së Kosovës;

POLICIA - Policia e Kosovës;

INSTITUCIONET PËR ZBATIM TË LIGJIT - të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit që kanë autorizimet policore;

HETIMI I INTEGRITETIT - teknika apo metoda që shërben për verifikimin e etikës dhe integritetin e punonjësve të Policisë së Kosovës.

INSPEKTIM - vlerësimi i mënyrës së kryerjes së detyrave në Policinë e Kosovës, duke siguruar arritjen e qëllimeve, në përputhje me legjislacionin dhe standardet e kërkuara;

INCIDENT DISIPLINOR I PROFILIT TË LARTË - incidenti ose trendi i ngjarjeve që tërheqin vëmendje domethënëse të publikut duke përfshirë, por pa u kufizuar në supozimet si:

- konflikte apo incidente të drejtpërdrejta në mes policisë dhe komuniteteve që ndërlidhet me veprimet racore, etnike apo diskriminuese;
- një problem akut i konfliktit të drejtpërdrejtë në mes policisë dhe komuniteteve. Konflikti mund të jetë në formën e ngacmimit, brutalitetit apo përdorimit të forcës së tepruar nga ana e Policisë;
- të gjitha incidentet e përdorimit të forcës vdekjeprurëse;
- të gjitha vdekjet gjatë mbajtjes nën kontroll nga policia;
- aksidentet fatale të trafikut ku përfshihen punonjësit e policisë;

ANKESAT NDAJ SHËRBIMIT - ankesa e bërë lidhur me standardet policore, udhëzimet operative apo parimeve të shërbimit policor.

ANKESAT PËR SJELLJE KRIMINALE – ankesa për sjelljet kriminale të punonjësve policor të bërë me dije autoriteteve përkatëse.

SHKURTESAT

| | |
|---------------|--|
| IPK | Inspektorati Policor i Kosovës |
| PK | Policia e Kosovës; |
| ICITAP | International Criminal Investigative Training Assistance Program; |
| EULEX | Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë; |
| AKSP | Akademia e Kosovës për Siguri Publike; |
| KEEP | Kodi Evropiane i Etikës Policore; |
| UE | Unioni Evropian; |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë; |
| PSO | Procedura Standarde të Operimit; |
| NJTR | Njësia e Trafikut Rajonal; |
| NJHR | Njësia e Hetimeve Rajonale; |
| NJHDPK | Njësia e Hetimeve të Drejtorisë së Policisë Kufitare; |
| DRP | Drejtoria Rajonale e Policisë; |
| DPP | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë; |
| DASHM | Departamenti i Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse; |



Institucioni i Avokatit Popullit në Kosovë
Institucija Ombudsmana na Kosovo
Ombudsperson Institution in Kosovo
Kosova Halkın Avukatı Enstitüsü



Raporti vjetor 2013




Inspektorati Policor i Kosovës

Hajvali, Prishtinë

044 192 911

info.ipk@rks-gov.net

www.ipk.rks-gov.net

 [inspektoratipolicor](https://www.facebook.com/inspektoratipolicor)